


FIGURA E ARMIKUT

ripërfytyrimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe



**qendra
multimedia**

FIGURA E ARMIKUT:
RIPËRFYTYRIMI I MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-SERBE

Prishtinë, 2016

FIGURA E ARMIKUT:
RIPËRFYTYRIMI I MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-SERBE

Redaktorë të botimit:
Rigels Halili, Aleksandar Pavloviq, Armanda Hysa, Adriana Zaharijeviq

Përkthyes:
Anton Berishaj, Agron Bajrami, Naile Mala- Imami, Filip Vukadinoviç

Për botuesin:
Jeton Neziraj

Botues:
Qendra Multimedia, Prishtinë
www.qendra.org / info@qendra.org

Lektura:
Armanda Hysa, Rigels Halili

Korrektura:
Ermirë Vrella

Disenji dhe thyerja grafike:
Ishulli

Shtypi:
Printing Press

Ky studim është përgatitur si pjesë e projektit *Figura e armikut: ripërfytyrimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe*, të realizuar në kuadër të Programit Rajonal për mbështetjen e kërkimit shkencor në fushën e shkencave shoqërore në Ballkanin perëndimor (RRPP), të cilin e drejton Universiteti i Frajburgut (Fryburg) nëpërmjet financimit të Agjensisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Mendimet e shprehura në këto studime janë pikëpamje të autorëve dhe nuk përfaqësojnë pikëpamjet as të Agjensisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe as të Universitetit të Frajburgut.

FIGURA E ARMIKUT

RIPËRFYTYRIMI I MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-SERBE

PËRMBAJTJA:

Hyrje nga redaktorët: një lloj tjetër marrëdhëniesh: 7

E kujt është kjo tokë?

Krijimi i armiqësisë serbo-shqiptare

Aleksandar Pavloviq: *Prej heroit në njeri të egër: Shqiptarët në diskursin heroik dhe kombëtar serb nga mesi i shekullit XVIII deri në fillim të shekullit XX* 15

Srgjan Atanasovski: *Prodhimi i Serbisë së Vjetër: në hapa të udhëtarëve, pas gjurmëve të folklorit* 37

Millan Milkoviq: *Kontribut për analizën e imazhit mediatik të shqiptarëve në shtypin serb 1912-1913* 59

Ana Petrov: *“Ballkani popujve të Ballkanit”: evolucionizmi, racizmi dhe kolonializmi në diskutet shkencore dhe politike serbe para Luftës së Dytë Botërore* 81

Vlladan Jovanoviq: *„Rekonkuista e Serbisë së Vjetër“: rreth kontinuitetit të politikës territoriale dhe demografike në Kosovë* 101

Përpjekja jugosllave

marrëdhëniet shqiptaro-serbe në kryqëzim perspektivash

Agron Bajrami: *Gazetat në shërbim të shtetit dhe të kombit*..... 123

Atdhe Hetemi: *Parë me sytë e të tjerëve: riprodhimi i orientalizmeve dhe ballkanizmi i brendshëm midis shqiptarëve dhe sllavëve të jugut në ish-Jugosllavi* 139

Marjan Ivkoviq, Tamara Petroviq Trifunoviq, Srgjan Prodanoviq:
Marrëdhëniet serbo-shqiptare në Jugosllavinë socialiste: Protestat në Kosovë dhe barra e legjitimitetit sistemor 163

Çfarë u mësojmë brezave të rinj?

Marrëdhëniet serbo-shqiptare në tekstet shkollore

Aleksandra Iliq Rajkoviq: *Shqiptarët dhe marrëdhëniet serbo-shqiptare në librat shkollorë serbë (1887-1987)* 189

Esilda Luku: *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948) dhe paraqitja e tyre në tekstet shkollore të histories* 211

Naile Mala-Imami: *Shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë dhe në jug të Serbisë (1945-2015)* 227

Shkëlzen Gashi: *Lufta në Kosovë 1998-1999 në librat shkollorë të historisë në Kosovë dhe në Serbi* 247

Cilët janë pakicë dhe ku?

Sfidat e jetës mes shumicës së të Tjerëve

- Armanda Hysa:** *Martesat e përzierra serbo-shqiptare: kur patriarkia thyen barrierat e nacionalizmit* 263
- Maria Mandiq, Ana Sivaçki:** *Gjuha dhe konflikti etno-politik: Rasti i gjuhës shqipe në Beogradin bashkëkohor* 283
- Inis Shkreli:** *Minoriteti serbo-malazez në Shkodër: Sfidat e identitetit* 307

Intelektualët dhe lufta: ndërmjetësit e të (pa)vërtetës kombëtare

- Rigels Halili:** *“Ne, bijtë e kombit” – intelektualët si gjenerues të ideve dhe programeve kombëtare shqiptare dhe serbe* 325
- Predrag Krstiq:** *Trajtimi intelektual i “Kosovës”: recepcionet, nënshtrimet ndaj fatit dhe reaksionet serbe* 345
- Gazela Pudar Drashko:** *Simbolika e pafuqisë: intelektualët dhe marrëdhëniet serbo-shqiptare në kontekstin postjugosllav* 365

Më vrit fjalë e fuqishme: shkrimtarët nëpër linjat luftarake të kombit

- Sasha Qiriq:** *Figura e tjetrit si projekt i hapur, në shembullin e autorëve shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova* 387
- Basri Capriqi:** *Armiq dhe njerëz* 403
- Anton Berishaj:** *Letërsia si diskurs lufte – shkrimtarët serbë dhe shqiptarë në “luftë me fjalë”* 419

A ka bashkëpunim pas gjithçkaje:

praktika kulturore dhe politike përmes kufijve

- Jelena Llonçar:** *Trashëgimia kulturore në Kosovë: nxitja e përjashtimit nëpërmjet legjislacionit inkluziv* 439
- Ana Bireshev:** *“Sy më sy”: bashkëpunimi kulturor serbo-shqiptar në diskursin mediatik* 459
- Adriana Zaharijeviq:** *Komuniteti i të shpronësuarave: Koalicioni paqësor i grave* 481

Maria Mandiq (Marija Mandić)

Ana Sivački (Ana Sivački)

Fakulteti Filologjik

Universiteti i Beogradit

Gjuha dhe konflikti etno-politik: Rasti i gjuhës shqipe në Beogradin bashkëkohor¹⁶¹

Abstrakt:

Në punim shqyrtohet ndikimi i konfliktit etno-politik në përdorimin e gjuhës shqipe në Beogradin bashkëkohor. Së pari jepet një tablo e përgjithshme e pakicës shqiptare në Serbi, e veçantive demografike të saj, institucioneve dhe përdorimit të gjuhës. Duke u nisur nga rezultatet e anketës sociolinguistike të kryer me folësit e shqipes në Beograd, në punim më pas analizohet përdorimi i gjuhës shqipe dhe varësia e tij nga konflikti etno-politik.

Fjalët kyçe:

sociolinguistika, studimet e konflikteve, gjuha shqipe, gjuha serbe, Beogradi, përdorimi i gjuhës, ideologjia gjuhësore, konflikti në Kosovë, shumëgjuhësia

¹⁶¹ Ky hulumtim po bëhet në kuadër të projektit rajonal „Figuring out the enemy: re-imagining Serbian-Albanian relations“, që është financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim – SDC, që është pjesë e Departamentit Federal për Punë të Jashtme, dhe në kuadër të projektit „Gjuha, folklori, migrimet në Ballkan“ (nr. 178010), që financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tehnologjisë e Republikës së Serbisë.

Shumëgjuhësia në qytetet e mëdha: rasti i Beogradit

Shumëgjuhësia ka kohë që është bërë objekt i interesimit akademik. Gupta (Gupta, 2000) argumenton se praktikat shumëgjuhësore mund të shërbejnë si bazë për dallimin e tipeve të qyteteve. Nga njëra anë janë qytetet 'kozmpole të vërtetë' ku „nuk ka asnjë grup dominant etno-linguistik, dhe ku modeli i ndërveprimit gjuhësor të gjithsejçilit përcaktohet nga shumëllojshmëria“; ky përcaktim vlen për Singaporin dhe qytete të tjera të mëdha, kryesisht në Lindjen e Mesme dhe Azi (Gupta, 2000, 109). Në anën tjetër janë qytetet e mëdha tregtare, pra qytetet globale – si Londra, Hong Kongu apo Njujorku – në të cilat nuk pritet që shumica të ndërrojnë modelin e vet të ndërveprimit gjuhësor si përgjigje ndaj jetës shumëgjuhëshe të qytetit dhe ku mbizotërojnë ende ideologjitë monolingvistike (po aty). Bastioni i këtyre ideologjive gjendet në Evropë, ku paradigma „një gjuhë – një komb – një shtet“ dhe ideologjia e „gjuhës standarde“ mbizotërojnë në shoqëri (krah. Milroy, Milroy, 1985). Megjithatë, shumëgjuhësia ka fituar një vend të privilegjuar në axhendën politike të Bashkimit Evropian. Dokumenti më i rëndësishëm evropian që përkufizon politikën gjuhësore është Karta Evropiane për Gjuhët Minoritare dhe Rajonale e vitit 1992, të cilin Unioni Serbi dhe Mali i Zi e ka ratifikuar më 15 shkurt të vitit 2006.¹⁶²

Praktikat shumëgjuhëshe në Beogradin bashkëkohor janë zhvilluar nën ndikimin e krizës së thellë shoqërore e politike që drodhi qytetin dhe rajonin. Gjatë viteve 90-të të shekullit XX, Beogradi dhe banorët e tij përjetuan shpërbërjen e përgjakshme të Jugosllavisë, regjimin autoritar dhe nacionalist të Slobodan Millosheviqit (Slobodan Milošević), luftërat në Kroaci dhe Bosnjë, sanksionet ekonomike të vëna nga Kombet e Bashkuara ndaj Serbisë në vitin 1992 dhe njërin prej hiperinflacioneve më brutale në histori. Në fund të viteve 90-të shpërtheu konflikti ushtrarak serbo-shqiptar në Kosovë, i cili përfundoi me bombardimin e Serbisë nga NATO, rrëzimin e Millosheviqit dhe ndarjen e Kosovës dhe Metohisë nga Serbia. Kriza politike dhe shoqërore e atyre viteve shkaktoi emigrime masive, të forcuara ose të vullnetshme, brenda e jashtë vendit dhe qytetit. Këto rrethana sociale dhe politike kontribuan në homogjenizimin etnik të vendit dhe nuk e nxistën jetën shumëgjuhëshe të kryeqytetit.

Sa i përket gjuhëve që fliten në qytet, mund të dallohen gjuhët minoritare që janë tradicionalisht të pranishme në Beograd, si gjuha hungareze, shqipe, rome, rumune, greke, etj.,¹⁶³ dhe gjuhët e reja të emigrantëve, si p.sh. gjuha kineze.¹⁶⁴ Përveç kësaj, fliten

¹⁶² Karta Evropiane për Gjuhët Minoritare dhe Rajonale
http://www.coe.org.rs/REPOSITORY/2858_european_charter_for_regional_or_minority_languages.pdf (vizituar më 21.03.2015)

¹⁶³ Këtu mund të shtojmë edhe kroatishten, boshnjakishten, gjuhën malazeze e bunjevake, që janë njohur zyrtarisht, por që në fakt janë variante të së njëjtës gjuhë, që bazohen në dialektin shtokavian sllavojugor, të njohur në ish Jugosllavi me emërtimin zyrtar gjuha serbo-kroate (krah. Kordić, 2010); krahas tyre, në Beograd flitet edhe gjuha sllovene, maqedone, gorane, dhe gjuhë tjera. Përveç kësaj, duhet theksuar se bashkësive tradicionale etnolingvistike në Beograd i takonin edhe dy gjuhë, por janë zhdukur pas Luftës së Dytë Botërore: gjuha hebraiko-spanjolle e hebrenjëve sefardikë (krah. Vučina Simović, Filipović, 2009) dhe gjermanishtja që flitej nga pakica gjermane.

¹⁶⁴ Nuk ekzistojnë të dhëna të sigurta se sa kinezë jetojnë në Beograd dhe Serbi. Jozyrtarisht, në Beograd jetojnë mes 10,000 dhe 20,000 kinezë; ata kanë nisur migrimin në Serbi gjatë viteve 1990-të. Blloku 70

edhe të ashtuquajturat 'gjuhë botërore', si gjuha angleze, gjermane, franceze, ruse, spanjolle, italiane, etj., ku gjuha angleze është *lingua franca*.

Konflikti dhe gjuha: lidhje e afërt?

Identiteti kolektiv dhe konflikti janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, ndërsa gjuha është sigurisht një nga shenjuesit më të rëndësishëm të identitetit kolektiv. Kështu, gjuha mund të kontribuojë në zhvillimin e konflikteve, për shkak të tyre ajo mund të përhapet apo të shtypet, por mund edhe të mos varet fare prej konflikteve (krah. Wright (red.) 1998; Smith, 1998). Meqë në Evropë gjuhët kombëtare janë bërë mjete më të rëndësishme të riprodhimit kulturor kombëtar, Çergo (Csergo, 2007, fq.6) argumenton se nacionalizmi evropian ka kontribuar në shfaqjen e konceptit të territorialitetit gjuhësor, i cili karakterizohet nga pritshmëria që hapësira kombëtare të hartëzohet nga një gjuhë kombëtare. Çergo thekson: „Që të sigurohet vazhdimësia e pronësisë, gjuha kombëtare i lidhi njerëzit me hapësirën kombëtare përmes socializimit me anë të sistemit arsimor, ku arsimi u zhvillua në frymën e idologjisë kombëtare. Mjetet kryesore për të përjetësuar kulturën kombëtare ishin letërsia, historiografia dhe gjeografia kombëtare, si dhe festat kombëtare, që gjithashtu përdornin gjuhën kombëtare për të nderuar historinë e kombit“ (Csergo, 2007, 6). Megjithatë, pakicat kombëtare që jetojnë në kuadër të sistemit komb-shtet i problematizojnë çështjet e lojalitetit kombëtar, homogenitetit dhe kërkesën për një gjuhë kombëtare të vetme. Pakicat, bashkë me garancitë institucionale për riprodhimin e kulturës së tyre në gjuhët përkatëse native, bëjnë thirrje edhe për përfshirjen e këtyre gjuhëve në institucionet publike dhe sistemin arsimor, (krah. Csergo, 2007, 8; Kymlicka, 2001).

Duke përdorur qasje të ndryshme metodologjike e teorike, siç janë sociolinguistika dhe studimi i konflikteve, ky punim përqëndrohet në përdorimin e gjuhës shqipe në Beograd. Në fillim jepet një tablo e përgjithshme e pakicës shqiptare në Serbi, tiparet e saj demografike, institucionet dhe përdorimi i gjuhës. Më pas, bazuar në të dhënat e anketës sociolinguistike të formuluar në kuadër të këtij studimi. Punimi analizon përdorimin e gjuhës shqipe në Beograd, e veçanërisht varësinë e tij nga konflikti serbo-shqiptar në Kosovë. Në punim argumentohet se, edhe pse përdorimi i gjuhës shqipe në Beograd është vështirësuar për shkak të konflikti në Kosovë, ekziston potenciali për zhvillimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor aty.

Shqifolësit në Serbi: regjistrimi i popullsisë

Ekzistojnë tre bashkësi ento-linguistike që përdorin gjuhën shqipe si gjuhë të vetën minoritare në Serbi: shqiptarët etnikë, ashkalinjtë dhe/apo egjiptianët e Ballkanit. Nga njëra anë, ashkalinjtë dhe egjiptianët ballkanas e konsiderojnë veten si grupe të

në Beogradin e ri njihet si Lagjja Kineze; <http://www.blic.rs/Vesti/Beograd/288403/Kako-zive-Kinezi-u-Beogradu> / vizituar më 21.03.2015/

veçanta etnike; nga ana tjetër, nuk pajtohen rreth emrit të bashkësisë dhe prejardhjes së saj (krah. Marušiakova, 2001).¹⁶⁵ Megjithatë, pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike i identifikojnë ashkalinjtë dhe egjiptianët ballkanas kryesisht si romë. Ata kështu bëjnë pjesë në „romë të hetero-identifikuar (të cilët) veten shpesh nuk e identifikojnë si romë“ (Bunescu, 2014, fq.1).

Vlerësimi i popullatës pakicë në Serbi kryesisht bazohet në regjistrimet e popullësisë. Në përgjithësi, regjistrimet janë një praktikë kundërthënëse shoqërore, në besueshmërinë e të cilave dyshohet edhe më shumë në shoqëritë që e traumatizua nga luftërat dhe konfliktet etnike, siç është rasti me Serbinë dhe pakicën e saj shqiptare. Shënimet numerike nga regjistrimet zakonisht shndërrohen në 'fakte të forta', që shërbejnë si „armë e fuqishme në betejat e mëtejshme politike dhe diskursive nga elitat, si edhe mes lëvizjeve opozitare të pakicave“ (Gal, 1993, 338, Foucault, 1994). Andaj, regjistrimet e popullsisë duhen përdorur si burime që sinjalizojnë trende shoqërore dhe duhen parë përmes prizmit të raporteve të pabarabarta të fuqisë dhe interesave politike të shumicës dhe të grupeve minoritare.

Vlerësimet e numrit të shqiptarëve etnikë dhe shqipfolësve në regjistrimet serbe, tregojnë se si kryqëzohen interesat e ndryshëm politikë dhe raportet e fuqisë në shoqëri. Regjistrimet e popullsisë të Republikës Socialiste së Serbisë në vitet 1948-81 përfshijnë Kosovën dhe Metohinë, kur shqiptarët përbëjnë shumicën absolute. Meqë popullsia shqiptare i ka bojkotuar regjistrimet e viteve 1991 dhe 2011, janë të mëdha variacionet numerike mes regjistrimeve të viteve 1981 dhe 1991, si dhe mes regjistrimeve të viteve 2002 dhe 2011. Për këtë arsye, numri i shqipfolësve në vitin 1991 bazohet në vlerësime që kanë të bëjnë vetëm me komunat jugore serbe të Preshevës dhe Bujanocit, ku jetojnë shumica e shqiptarëve në Serbi.

Tabela 1 – Nacionaliteti shqiptar dhe gjuha shqipe si gjuhë amtare në Serbi dhe Beograd, sipas regjistrimeve të popullsisë (Regjistrimi i popullsisë 2011, fq.16, 21; Enti Statistikor i Republikës së Serbisë)

| Viti i regjistrimit | Nacionaliteti shqiptar – Serbi | Gjuha shqipe amtare – Serbi | Përkatësia shqiptare – Beograd | Gjuha shqipe amtare – Beograd |
|---------------------|--------------------------------|-----------------------------|--------------------------------|-------------------------------|
| 1948 | 532.011 | / | | |
| 1953 | 565.513 | 561.976 | 3.687 | - |
| 1961 | 699.772 | 684.166 | 8.262 | - |
| 1971 | 984.761 | 967.416 | 6.978 | - |

¹⁶⁵ Pjesëtarët e ashkalinjve konsiderojnë se egjiptianët ballkanikë i takojnë grupit të tyre, por nuk e nxjerrin prejardhjen e tyre nga Egjipti. Ndërsa, egjiptasit ballkanikë pohojnë se ashkalinjtë janë pjesë e bashkësisë së tyre, e cila rrjedh nga Egjipti (krah. Zemon).

| | | | | |
|-------|-----------|-----------|-------|-------|
| 1981 | 1.303.034 | 1.309.197 | 8.212 | - |
| 1991* | 78.281* | 19.004* | 5.370 | - |
| 2002 | 61.647 | 63.835 | 1.492 | 2.753 |
| 2011 | 5.809 | 10.040 | 1.252 | 3.832 |

Numri i shqiptarëve në Beograd është rritur në mënyrë domethënëse mes viteve 1960 dhe 1990, ndërsa në periudhën mes viteve 1990 dhe 2011 zvogëlohet përnjëherë. Shtimi i numrit të shqipfolësve mund të shpjegohet me klimën e përshtatshme politike, mundësitë për punësim dhe zhvillimin industrial në Republikën e atëhershme Socialiste Federative të Jugosllavisë. Ndërsa, zvogëlimi i numrit të shqipfolësve në Beograd vjen si rezultat i përkeqësimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve politike serbo-shqiptare. Kriza në marrëdhëniet serbo-shqiptare arrin kulmin gjatë luftës në Kosovë dhe sulmit të NATO-s kundër Serbisë në vitet 1998-99. Krahas emigrimit të vazhdueshëm të shqipfolësve dhe shqiptarëve nga Beogradi së voni, në mesin e shqiptarëve vërehet edhe tendenca që të mos deklarohen përkatësinë kombëtare apo të përcaktojnë ndodnjë identitet tjetër kombëtar në regjistrimet e popullatës.¹⁶⁶ Domethënë, bazuar në vëzhgimin me pjesëmarrje dhe bisedat me popullatën lokale shqiptare, kemi arritur në përfundimin se shqiptarët në Beograd prej vitit 1980, shpesh përdorin mimikrinë dhe deklarohen si goranë.¹⁶⁷

Shumica e shqipfolësve nga rradhët e pjestëtarëve të kombësisë shqiptare në regjistrime deklarohen si shqipfolës të etnicitetit joshqiptar, siç janë egjiptasit ballkanas dhe ashkalinjtë. Ky dallim është veçanërisht i dukshëm në Beograd në regjistrimin e vitit 2011, sipas të cilit ka dy herë më shumë folës të gjuhë shqipe se sa shqiptarë etnikë (Regjistrimi 2011, fq.16, 21; Gjurić et al., 2014, 98 dhe 151).

Shqipfolësit në Serbi: rrjeti institucional

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2002, ka pasur 57.737 folës të gjuhës shqipe në komunat e Serbisë jugore, në të cilat, siç u përmend, jetojnë shumica e shqiptarëve në Serbi (96.1%); në Preshevë ata përbëjnë shumicën absolute (97%), në Bujanoc më shumë se gjysmën e popullatës (62%), ndërsa në Medvegjë përbëjnë një të tretën (28.67%). Siç vëren Nenadiq (Nenadić) (2010, 34): „Këto komuna konsiderohen të pazhvilluara, sipas indikatorëve, siç janë përqindja e lartë e papunësisë dhe varfërisë, infrastruktura e pazhvilluar, trendet negative të migrimit dhe emigrimit të popullatës,

¹⁶⁶ Në instruksionet zyrtare dhënë nënshkruesve të Regjistrimit të fundit në vitin 2011, thuhet se sipas Kushtetutës serbe (KUSHTETUTA 2006) qytetarët nuk janë të obliguar të deklarohen përkatësinë fetare dhe etnike. Në regjistrimin e fundit të vitit 2011, 2.23% e popullsisë nuk janë deklaruar në aspektin e etnicitetit (Gjurić et al., 2014, fq.114).

¹⁶⁷ Goranët janë bashkësi sllave muslimane që popullon rajonin e Gorës – zonë në kufi mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë; ata flasin një dialekt sllavojugor (Gjurić et al., 2014, fq.114).

mungesa e resurseve njerëzore dhe shumë probleme të tjera shoqërore". Shumica e të punësuarve punon në dy sektorë - prodhim (p.sh. duhani, plastika) dhe arsimim (Maksimović, 2015).

Rrjeti instritucional shqiptar nuk është i zhvilluar sa duhet. Institucionet më të rëndësishme shqiptare në Serbi janë Ambasada e Republikës së Shqipërisë, institucionet arsimore (prej çerdheve deri në nivelin universitar), si dhe institucionet mediatike dhe politike. Numri i nxënësve që vijnë shkollat fillore dhe të mesme serbe në gjuhën shqipe është 10.000 (IANS, 2013, 3). Në komunën e Preshevës ka 11 institucione arsimore: një parashkollor, tetë shkolla fillore (njëra ka mësim në gjuhën serbe, të tjerat në gjuhën shqipe), është Shkolla e Mesme Teknike "Presheva" (i tërë arsimi për të katër vitet në 39 paralele është në gjuhën shqipe, ndërsa në 4 paralele në gjuhën serbe) dhe Gjimnazi "Skenderbeu" (31 paralele në gjuhën shqipe, 4 paralele në gjuhën serbe).¹⁶⁸ Në komunën e Bujanocit janë 15 institucione arsimore: një parashkollor (me mësim në gjuhën shqipe dhe në atë serbe), 11 shkolla fillore (6 me mësim në gjuhën shqipe, 4 në gjuhën serbe dhe një e përzier), Shkolla Profesionale "Sveti Sava", në të cilën gjuha mësimore është serbishtja, Gjimnazi "Sezai Surroi" me mësim në gjuhën shqipe (47 paralele në shqip). Ekziston po ashtu edhe Shkolla për arsimim fillor muzikor me mësim në gjuhën serbe.¹⁶⁹ Në Medvegjë janë 8 institucione arsimore: çerdhja, gjashtë shkolla fillore (3 me mësim edhe në gjuhën serbe edhe në gjuhën shqipe, dhe 3 vetëm në gjuhën serbe), Shkolla e Mesme Teknike „Nikola Tesla“ (14 paralele në gjuhën serbe dhe 4 në gjuhën shqipe) (krah. Nenadić, 2010, fq.34).

Edhe pse këto komuna janë etnikisht të përziera, shkollat fillore e deri diku edhe ato të mesme në Bujanoc dhe Preshevë, dallohen për nga segregacioni etnik: shkollat fillore në gjuhën serbe i vijnë nxënësit serbë dhe romë, ndërsa shqiptarët vijnë shkollat në gjuhën shqipe; vetëm në fshatrat Relan dhe Birçë mësimi zhvillohet në të dy gjuhët nën të njëjtin kulm në shkollat fillore (Nenadić, 2010, fq.34). Kjo do të thotë se shpesh herë nxënësit nuk kanë rast që të takojnë moshatarët e tyre nga grupet tjera etnike. Për dallim prej tyre, në komunën e Medvegjës ekzistojnë paralelet në gjuhën serbe dhe ato në gjuhën shqipe në kuadër të të njëjtave shkolla fillore (Nenadić, 2010, fq.34).¹⁷⁰

Rinia serbe nga Bujanoci dhe Presheva zakonisht e vazhdon arsimimin e vet në Nish, Beograd dhe qytete tjera serbe, ndërsa rinia shqiptare e vazhdon atë më së shumti në Prishtinë, Maqedoni apo Shqipëri (Nenadić, 2010, fq.34-35). Megjithatë, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik kanë ligjerata edhe në gjuhën serbe edhe në atë shqipe, ku Seksioni për Gjuhën Shqipe është i vendosur në Medvegjë (Nenadić, 2010, fq.35). Një qendër shumë e rëndësishme arsimore është Katedra për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqipe e Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit.

Situatën mediale Këshilli Kombëtar Shqiptar e ka vlerësuar si të mirë në parim, meqë ka disa media që emitojnë programe në gjuhën shqipe: Radio-Televizioni i Pre-

¹⁶⁸ Krah. [http://www.presevo.rs/index.php/sr-YU/vizituar më 21.03.2015/](http://www.presevo.rs/index.php/sr-YU/vizituar%20m%C3%A9%2021.03.2015/)

¹⁶⁹ Krah. [http://www.bujanovac.rs/vizituar më 21.03.2015](http://www.bujanovac.rs/vizituar%20m%C3%A9%2021.03.2015/)

¹⁷⁰ Krah. [http://www.medvedja.org.rs/vizituar më 21.03.2015/](http://www.medvedja.org.rs/vizituar%20m%C3%A9%2021.03.2015/)

shevës, Radio-Televizioni i Bujanocit, Radio Presheva, Radio Bujanoci, e më tej Televizioni privat Aldi nga Presheva dhe Televizioni privat Spektri nga Bujanoci, të cilat të dyja emitojnë program në gjuhën shqipe (IANS, 2013, fq.5). E vetmja gazetë në gjuhën shqipe është javorja “Nacionali”, por edhe ajo është në situatë të rëndë financiare dhe në kufi të mbijetesës; fillimisht, gazetat janë përkrahur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Serbisë, por më pas ky financim është mbartur tek Këshilli Kombëtar Shqiptar (po aty).¹⁷¹

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe

Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe është, sipas raportit të Këshillit Kombëtar Shqiptar, në disa segmente në nivel jo të kënaqshëm, ndërsa në disa tjera ende nuk është në pajtim me ligjet shumë të përparuara për mbrojtjen e pakicave dhe gjuhëve të pakicave, në fuqi në Serbi, e as që plotëson kushtet e parapara nga Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Minoriteteve, të cilën zyrtarët serbë e kanë ratifikuar. Meqë popullsia shqiptare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë tejkalon 15%, gjuhë zyrtare në nivel të këtyre komunave janë edhe gjuha shqipe edhe ajo serbe. Megjithatë, ligjet më të rëndësishme republikane ende nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe; përjashtim bëjnë vetëm ligjet si Ligji për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (IANS, 2013, fq.6).

Tabelat në institucionet shtetërore në Luginën e Preshevës, siç e thekson Këshilli Kombëtar Shqiptar, janë të shkruara vetëm në gjuhën serbe dhe me alfabet cirilik, përfshirë stacionet policore, Entin Republikan për Gjeodezi, Shërbimin e Kadastrës dhe Hartografisë, Entin Republikan për Sigurim Shëndetësor, shërbimet tatimore, Byronë Kombëtare për Punësim dhe Fondin Republikan për Sigurim Pensional. Përveç kësaj, Enti Republikan për Gjeodezi, institucionet mjekësore dhe stacionet policore lëshojnë dokumente vetëm në gjuhën serbe dhe në alfabetin cirilik. Regjistrimi i ndërmarrjeve, i gjithë materiali zgjedhor dhe rejgistrat e votuesve shtypen vetëm në gjuhën serbe (IANS 2013, fq. 8). Të sapolindurit shqiptarë, siç thotë Këshilli Shqiptar, i marrin certifikatat nga librat amë në gjuhën serbe, gjë që më tutje shkakton gabime të shumta në shkrimin e emrave origjinalë shqiptarë në kartat e identitetit dhe në pashaporta (IANS, 2013, fq.8). Edhe pse gjuha shqipe është në përdorim zyrtar në komunën e Medvegjës, sipas Këshillit Kombëtar Shqiptar, asnjë nga të punësuarit në shërbimin administrativ për regjistrim nuk është shqiptar; më tej, vendimet dhe vërtetimet komunale në Medvegjë nuk lëshohen në gjuhën shqipe (IANS, 2013, fq.10).

Në raportin e Këshillit Kombëtar Shqiptar pohohet se nuk ka shqipfolës e as përkthyes në administratën e policisë (IANS, 2013, fq.8). Megjithatë, pas rënies së Millosheviqit në tetor të vitit 2000, qeveria e re serbe ka zhvilluar një plan për zgjidhjen paqësore të krizës në jug të Serbisë. Duke filluar nga viti 2001, janë themeluar njësitet

171 Krah. <http://www.politika.rs/rubrike/Tema-nedelje/SHta-zele-stranke-nacionalnih-manjina/t51926.lt.html>
<http://www.blic.rs/Vesti/Politika/501023/Albanci-na-izbore-na-jugu-Srbije-u-tri-kolone> /vizituar më 22.03.2015/

e përziera etnike të policisë të përbëra nga oficerë policorë me përvojë, prej të cilëve më shumë se gjysma janë shqiptarë (Stodiek, 2006, fq.43–60).

Ndërkohë, në Serbi në vitin 2008 është miratuar Ligji për Organizimin e Gjykatave dhe Gjykata Themelore në Vranjë ka punësuar pesë gjykatës me prejardhje shqiptare, nga 43 gjithsej. Meqë në rajonin e Pčinjit, të cilit i përket kjo gjykatë, shqiptarët përbëjnë 25% të popullatës, Këshilli Kombëtar Shqiptar konsideron se kjo përqindje e gjykatësve shqiptarë nga numri i gjithë gjykatësve ende nuk është i kënaqshëm (IANS, 2013, fq.6–13).

Hulumtimi sociolinguistik

Hulumtimi i gjuhës shqipe bëhet në kuadër të projektit-pilot “Shumëgjuhësia në Beograd sot”, që është krijuar nga ekipi i hulumtuesve dhe bashkëpunëtorëve të Institutit Ballkanologjik të ASShA-së dhe Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit. Deri tani janë përfshirë gjuha hungareze, gjuha rumune dhe gjuha shqipe.¹⁷² Hulumtimi i gjuhës shqipe bazohet në pyetësorët sociolinguistikë që u janë ndarë shqipfolësve në Beograd, ku ende nuk janë përfshirë egjiptasit ballkanas dhe ashkalinjtë. Krahas pyetësorit dhe qasjes kuantitative, kemi përdorur edhe metodën e vëzhgimit me pjesëmarrje. Në formën e vet themelore, kjo qasje implikon korelacionin mes gjuhës dhe faktorëve shoqërorë, në mënyrë që të identifikohet konteksti shoqëror në të cilin këto funksionojnë (Filipović, 2009, fq.24). Pyetësori është ndarë në tri pjesë:

- A. Domeni – përdorimi i gjuhës në domenet e ndryshme;
- B. Komunikimi – përdorimi i gjuhës në mjediset e ndryshme komunikative;
- C. Qëndrimet – qëndrimet ndaj përdorimit të gjuhës.

¹⁷² Rezultatet e këtij projekti janë prezantuar në një punim shkencor dhe në shumë tubime shkencore: (artikulli) Bálla et al., 2012; tubimet: (prezantimi) Bálla, M., Bulanović, S., Ilić, M. Monolingualism vs. Multilingualism in Belgrade Today: The Domains of Hungarian Language Use”, në tubimin: Concepts and Consequences of Multilingualism in Europe 3, 08–11. 06. 2011, Peçuj, Hungari, Osijek, Kroaci; (prezantimi) Bulanović, S., Balla, M, Ilić, M. Hungarian in Contemporary Belgrade: a Case of Compartmentalised Language?, në tubimin: The 19th Sociolinguistics Symposium „Language and City”, 21–24. 07. 2012, Berlin, Gjermani; (prezantimi) Bulanović, S., Balla, M., Ilić M. Between the Word of Law and Practice: the Case of Hungarian Speakers in Serbia, në tubimin: Conference on minority representation and minority language rights: Origins, experiences and lessons to be learned, 11–14. 10. 2012, Cluj-Napoca, Rumania; (prezantimi) Bulanović S., Ilić, M. Hungarian in the linguistic landscape of Serbia: A comparison between Belgrade, Pancevo and Debeljaca, në tubimin: Theory and Practice of Linguistic Landscape Research on East-Central European Minorities, 23. 05. 2013, Budapest, Hungari; (prezantimi) Bulanović, S, Ilić, M. Hungarian in contemporary Belgrade: The role of language ideologies; (prezantimi) Sivački A., Osmani V., Ilić M. Language use and ethno-political conflict: The case of Albanian in contemporary Belgrade, në tubimin: ICML XIV International Conference on Minority Languages XIV, 11–14. 09. 2013, Grac, Austri; (prezantimi) Huțanu, M., Sorescu-Marinković A., Mandić M. Comunități românești în Belgrad: privire de ansamblu și perspective de cercetare, në tubimin: Al cincilea simpozion internațional de lingvistică, 27. 09. 2013, Bukuresht, Rumania; (prezantimi) Sorescu-Marinković A., Huțanu M., Mandić M. Multilingualism and ethnic fragmentation on the European periphery: Romanian language use in the city of Belgrade, në tubimin: Borders and Identities 2015: Urban Fragmentation(s), Humboldt University Berlin, 16–19. 03. 2015.

Anketa ishte anonime, ndërsa shënimet personale janë kërkuar vetëm për arsye të analizave statistikore, dhe ato përfshijnë moshën, gjininë, shkollimin, vendin e rritjes dhe shkollimin parauniversitar, si dhe vendin e banimit. Shqipfolësve që kanë marrë pjesë në hulumtim (në tekstin e mëtejshëm: folësit) u është ofruar të zgjedhin mes dy versioneve gjuhësore të pyetësorëve, serbisht dhe shqip, si dhe mes dy metodave të plotësimit - kompjuterik apo të shtypur. Pyetësori përmban 60 pyetje dhe shumë prej tyre janë të hapura; prej folësve kërkohet që të shkruajnë përgjigjen apo komentin, siç shihet nga shembujt në vijim:

7. i shmangem përdorimit të gjuhës shqipe në publik:

◇ po ◇ jo

◇ Nëse „po“, pse? _____

A ka mjaft programe dhe përmbajtje kulturore në gjuhë shqipe, sipas mendimit tuaj:

◇ në Beograd ◇ mjaft ◇ jo mjaftueshëm ◇ asnjë

◇ në Serbi ◇ mjaft ◇ jo mjaftueshëm ◇ asnjë

A kaloni gjithmonë në gjuhën shqipe nëse grupit tuaj i bashkohet një person që flet shqip?

◇ po ◇ jo

◇ Varet prej _____

59. Fakti që kam prejardhje shqiptare dhe jetoj në Beograd vetëm më ka sjellur:

◇ dobi


◇ dëm

◇ _____

Folësit e gjuhës shqipe: shënimet e përgjithshme

Pyetësori është shpërndarë mes disa grupeve të shqipfolësve, kryesisht studentë dhe ish- studentë të Seksionit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqipe të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit, të afërmve të tyre, miqve dhe të njohurve. Deri tani janë plotësuar 50 pyetësorë: 35 folës kanë zgjedhur formularin në gjuhën serbe, ndërsa 15 atë në gjuhën shqipe. Dallohen dy kategori kryesore moshore: më të rinj se 30 vjeç dhe më të moshar se 50 vjeç, ku dominojnë studentët dhe ish studentët që i takojnë kategorisë së parë. Më tutje, gjinia e folësve i përshtatet distribuimit të gjinisë mes studentëve të Fakultetit Filologjik: dy të tretat apo 34 (68%) janë femra dhe një e treta apo 16 (31%) janë meshkuj. Grafiku 1 paraqet folësit sipas moshës dhe gjinisë, ku moshja është ndarë në katër nënkategori: theksojmë se katër nuk i janë përgjigjur të gjitha pyetjeve.

Grafiku 1. Folësit sipas moshës dhe gjinisë



Sa i përket arsimimit, pyetëtori është harmonizuar me sistemin arsimor në Serbi, ndaj jepen pesë kategori të ndryshme, siç mund të shihet më poshtë në grafikun 2. Analiza tregon se ka një numër të barabartë të folësve me arsimim fillor dhe me shkollë të lartë (4% secili grup). Nga ana tjetër, folësit me shkollë të mesme përbëjnë një të tretën (27%), ndërsa më shumë se gjysma kanë diplomë fakulteti (54%), krahas folësve (14%) që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje.


Grafiku 2. Folësit sipas shkollimit



Besimi fetar i folësve nuk i përgjigjet pritjeve tona, sepse shumica e shqiptarëve janë të besimit islam. Por, në mostrën tonë ka një numër pothuaj të njëjtë të myslimanëve (39%) dhe ortodoksëve (36%), ndërsa katolikë ka shumë më pak (6%), më pas vijnë ateistët (4%) dhe „të tjerët“ (4%). Përkatësia fetare e folësve nuk i përgjigjet situatës në Kosovë dhe Shqipëri; në Kosovë, shqiptarët katolikë përbëjnë më pak se 5%, ndërsa shqiptarët muslimanë 95% të popullatës shqiptare; në Shqipëri ka rreth

60% shqiptarë myslimanë, 10% katolikë dhe më pak se 5% ortodoksë (Blumi, 2007, 213; Regjistrimi i Popullsisë në Shqipëri 2011). Përqindja e madhe e ortodoksëve në mesin e shqipfolësve në Beogradin kryesisht ortodoks, mund të shpjegohet në këtë mënyrë: (i) disa prej folësve kanë prejardhje serbe apo (ii) vijnë nga martesat e përziera mes serbëve dhe shqiptarëve.

Grafiku 3. Folësit sipas besimit fetar



Përgjigjet për vendin e banimit në fëmijëri dhe gjatë shkollimit janë të shumëllojshme; numri më i madh i folësve janë rritur në Beograd (40%), më pas në Serbinë jugore (22%), në pjesë tjera të Serbisë (14%), Kosovë (3%), dhe në Maqedoni e Mal të Zi (1% secili).

Grafiku 4. Folësit sipas vendit të banimit gjatë fëmijërisë dhe shkollimit para fakultetit



Hulumtimi ynë tregon se pakica shqiptare në Beograd është mjaft e asimiluar, sepse asnjë nga folësit nuk ka përmendur ndonjë traditë apo ritual tipik shqiptar që e kryejnë në rrethin e familjes, e as ndonjë festë tradicionale shqiptare që e festojnë, përveç ruajtjes së gjuhës dhe traditave fetare, që nuk mund të konsiderohen tipike shqiptare, por pjesërisht myslimane ose të kulturës së krishterë.


Domenet e përdorimit të gjuhës shqipe

Në dallim nga Serbia jugore, ku në tri komunat gjuha shqipe është gjuhë zyrtare, dhe ku për këtë ka edhe shumë vende formale e joformale në të cilat tubohen shqipfolësit, në Beograd situata është thelbësisht ndryshe. Ekzistojnë në fakt tri vende në të cilat shqipfolësit mbledhen: Katedra e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqipe në Fakultetin Filologjik, të Universitetit të Beogradit, Bajrakli Xhamia dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë. Folësit kanë theksuar se Katedra është vendi i vetëm ku mund të gjejnë literaturë në gjuhën shqipe.¹⁷³ Papritur, një folës përmendi edhe një kafe lokale në Beograd, ku flitet gjuha shqipe. Më tej, një numër befasues i madh (gati një e katërta) i folësve e përdor gjithmonë gjuhën shqipe në punë (22%), gjë që tregon për praninë e saj të shtuar në publik. Kjo është veçanërisht interesante nëse shihet nga perspektiva e hulumtimit tonë, sipas të cilit gati një e treta (30%) konsiderojnë se njohja e gjuhës shqipe është jashtëzakonisht apo mjaft e dobishme, ndërsa dy të tretat e folësve konsiderojnë se njohuria e gjuhës shqipe nuk u sjell dobi në Beograd.

Gjuha shqipe në Beograd përdoret kryesisht në sferat private, siç janë rrethi familjar dhe ai i miqve. Gjysma e folësve gjithmonë e përdorin gjuhën shqipe me anëtarët e familjes dhe miqtë (46% përkatësisht 42%), që është në kundërshtim me gjysmën tjetër, e cila kurrë apo shumë rrallë e përdor gjuhën shqipe në këto kontekste (36% përkatësisht 18%). Prandaj, edhe pse e kompartmentalizuar dhe e padukshme në publik, gjuha shqipe ende përdoret në rrethin e familjes dhe miqve. Grafiku 5 tregon numrin e folësve sipas secilit domen dhe frekuencës së përdorimit të gjuhës.


¹⁷³ Nisma për të nisur studimet e “etnografisë, gjuhës dhe të folurit të arbanasëve dhe turqve ballkanikë” është marrë në vitin 1907 nga Jovan Cvijiqi (Jovan Cvijić), rektor i Universitetit të Beogradit, i cili ishte i përkushtuar ndaj idesë që “linguistët tanë të hartojnë gramatikën (e gjuhës arbanase) dhe të mbledhin folklorin arbanas”. Në vitin akademik 1920/21, Henrik Bariq (Henrik Barić) nisi të mbajë një kurs të studimeve historike të gjuhës shqipe në kuadër të gjuhëve indoevropiane; kursi u quajt Historia dhe gramatika e gjuhës shqipe. Në periudhën 1923-26, Henrik Bariq botoi revistën shkencore nën titullin *Arhiv za arbanasku starinu* (*Arkivi për lashtësitë arbanase*), dhe mbledhi një numër të madh veprash të autorëve lokalë e të huaj në gjuhën shqipe; përveç kësaj, ai themeloi edhe arkivin e bibliotekës. Më 1925 Bariqi themeloi Seminarin e filologjisë arbanase në Fakultetin Filologjik dhe u emërua si shef i parë i tij. Ai hartoi Fjalorin e gjuhës serbe apo kroate dhe gjuhës shqipe (1950) dhe Historinë e gjuhës shqipe (1959). Prej viti 1960, Katedra e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqipe ka vazhduar punën në kuadër të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Beogradit, fillimisht si Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e më pas si Katedra e Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqipe. Sot, Katedra ka gjithsesjtë 54 kurse: 34 kurse të obliguara profesionale dhe 20 kurse fakultative, ku çdo vit regjistrohen rreth 10 studentë.

Grafiku 5. Domeni dhe frekuenca e përdorimit të gjuhës shqipe




Numri më i madh i folësve nuk e përdorin kurrë gjuhën shqipe në transportin publik, në rrugë apo në vendet e zbavitjes, siç janë baret, kafenetë e restorantet. Përkundër kësaj, një e katërta e folësve ka deklaruar se gjithmonë apo shpesh e përdorin gjuhën shqipe në vendet publike, siç shihet nga Grafiku 6 më poshtë:

Grafikoni 6. Përqordrimi i gjuhës shqipe në vendet publike




Dy grafiket e radhës tregojnë zgjedhjen e gjuhës në mediat e ndryshme, qoftë të shtypura, qoftë elektronike. Grafiku 7 tregon se përmbajtjet online janë më të popullarizuara, gjë që pasqyrohet në përqindjen më të madhe të atyre që i lexojnë rregullisht shkrimet shqipe online (36%), krahasuar me ata që lexojnë libra (20%) dhe gazeta. (12%) (Grafiku 8).

Grafiku 7. Serbishtja dhe shqipja në përzgjedhjen e përmbajtjeve në radio dhe online




Grafiku 8. Përdorimi i mediave të ndryshme në gjuhën shqipe



Vetëm një e treta i është përgjigjur pyetjes rreth programit të TV në shqip, kështu që kjo mostër nuk mund të konsiderohet përfaqësuese, por vlet të përmendet se numri i folësve (12%) që shikoj shpesh TV-në në shqip është i vogël. Për rregullimet në telefonat celularë gjuha angleze përdoret më shpesh, meqë më shumë se gjysma (56%) kanë zgjedhur anglishten si gjuhë operative, ndërsa një numër më i vogël përdor gjuhën shqipe (8%), apo serbe (13%).


Veçanërisht interesante është të shihet se çfarë mendojnë folësit për vlerën përdoruese të gjuhës shqipe në vendet dhe rajonet e ndryshme. Ata konsiderojnë se gjuha shqipe është jashtëzakonisht e dobishme në Kosovë (76%), më pas në Maqedoni (48%), në Serbinë qendrore (40%), në Serbinë jugore (15%), që në fakt nuk i përshtatet pranisë numerike të shqiptarëve në rajonet e përmendura. Ndoshta folësit e përdorin gjuhën serbe në rajonet njëgjuhësore apo dygjuhësore serbe, siç është Serbia jugore. Pamja është dhënë në Grafikon 9 më poshtë:

Grafiku 9. Vlera përdoruese e gjuhës shqipe sipas rajoneve nga këndi i folësve



Një tjetër pamje fitohet kur vëzhgohet shkalla e lidhjes emotive të folësve për vendet e ndryshme në të cilat flitet gjuha shqipe, qoftë si gjuhë minoritare, apo si gjuhë e shumicës. Në këtë rast, shumica është më e lidhur nga ana emotive me Beogradin (74%), më pas me Kosovën (56%) dhe Serbinë (52%). Meqë një numër i papërfillshëm i folësve vijnë nga Kosova, ne supozojmë se folësit e përjetojnë Kosovën si një qendër të rëndësishme të kulturës shqiptare. Prandaj, është e qartë që folësit janë njëloj të lidhur me atdheun e tyre (Serbinë) dhe vendin që e përjetojnë si qendër të kulturës së vet etnike (Kosovën). Befasisht, në anën tjetër të boshtit është Shqipëria (40% e folësve e kanë zgjedhur përgjigjen „1 – nuk jam aspak i/e lidhur“). Krahas kësaj, një e treta (30%) kanë deklaruar se janë të lidhur shumë pak me Serbinë jugore, ndërsa më tej një numër i madh nuk është aspak i lidhur me Kosovën (26%). Këto shënime mund të shpjegohen më faktin se folësit në pjesën më të madhe të rasteve i përkasin brezit të dytë në Beograd, ndaj janë dobësuar lidhjet me vendin e perjardhjes të prindërve. Pamja e përgjigjeve është dhënë në Grafikon 10, më poshtë. Folësit janë pyetur për të vlerësuar nivelin e lidhjes së tyre emotive me një vend të caktuar në shkallë prej 1-5: 1 – aspak (e kaltër e çelët); 2 – pak (ngjyrë vjollcë); 3 – mesatarisht (e gjelbër); 4 – shumë (e kuqe); 5 – jashtëzakonisht (e kaltër e mbyllur):

Grafiku 10. Lidhja emotive e folësve me rajone/vende të ndryshme në të cilat flitet gjuha shqipe



Gjuha dhe konflikti etno-politik

Siç kemi treguar, nuk ka shumë raste ku përdoret gjuha shqipe në Beograd, sepse njerëzit kryesisht nuk e njohin atë dhe nuk ekzistojnë vende joformale në të cilat flitet. Një nga pyetjet tona ka qenë nëse folësit i shmangen përdorimit të gjuhës shqipe në vendet publike. Hulumtimi ka treguar se, në raste kur ka bashkëbisedues që e flasin gjuhën shqipe, atëherë ata bisedojnë lirshëm në vendet publike. Për ne e papritur ishte

që vetëm një e treta (27%) deklaroi se i shmangen përdorimit të gjuhës shqipe në vendet publike, ndërsa dy të tretat e mbetura të folësve (73%) deklaruan se nuk hezitojnë ta flasin. Megjithatë, kur krahasohet me hulumtimin e gjuhës hungareze dhe asaj rumune në Beograd, është e qartë se përqindja e atyre që ndjehen të lirë që ta përdorin hungarishten dhe rumanishten në vendet publike është 20% më e madhe se sa e atyre që shqipen e flasin pa hezitim, që është 98% e folësve hungarezë dhe 90% e folësve rumunë.¹⁷⁴ Një nga folësit komentoi se një prej arsyeve kryesore për përdorimin e gjuhës shqipe në vendet publike, pa marrë parasysh konfliktin e Kosovës, është se „e kanë vështirë (ata që nuk e flasin) ta njohin se cila gjuhë është në fakt“.


Kur pyetëm në mënyrë të drejtpërdrejtë folësit që të përmendin situatat në të cilat mund të merrnin kërcënime, apo do të ndjeheshin pakëndshëm ndërsa flasin shqip, ata janë përgjigjur kryesisht se nuk kanë pasur situata të tilla; gjithësejt 90% e folësve nuk kanë përjetuar kurrfarë situata të pakëndshme. Njëri folës tha se i është tërhequr vërejtja që të mos flasë shqip me zë të lartë në prag të ndeshjes Serbisë-Shqipëri, që u luajt më 16 tetor 2014 në Beograd.¹⁷⁵ Folësit e tjerë përmendin, për shembull, e-maillet kërcënuese „ndoshta nga shokët e studimeve prej seksioneve tjera (të Fakultetit Filologjik) që kanë parë se cilën gjuhë studioj dhe më kanë shkruar“. Përveç kësaj, njëri folës ka deklaruar se një prej miqve të tij nuk lejon që të flitet gjuha shqipe në praninë e tij. Në pajtim me vëzhgimet e lartpërmendura se beogradasit nuk mund ta njohin gjuhën shqipe kur ajo flitet zëshëm në vend publik, një numër befasues i madh i folësve, një e treta (30%), thanë se e përdorin gjuhën shqipe si „gjuhë sekrete“ në vend publik. Arsyet e përmendura ndryshojnë, por shumica shpjegojnë se e përdorin gjuhën shqipe kur nuk duan që dikush në rrethin e tyre t'i kuptojë, ndërsa një folës tha se e flet shqipen kur sheh „një vashë të bukur serbe“. Më tutje, folësit me prejardhje shqiptare janë pyetur nëse prejardhja e tyre u ka sjellë dobi apo dëm në Beograd. Sipas përgjigjeve del qartë se kjo varet nga përvoja personale, sepse 15% e folësve kanë zgjedhur optionin „ka sjellë vetëm dobi“, 18% „ka sjellë vetëm dëm“, ndërsa dy të tretat e mbetura (67%) kanë zgjedhur „të tjera“.

¹⁷⁴ Shënimet janë dhënë bazuar në analizën preliminare të përdorimit të gjuhës hungareze dhe asaj rumune në Beograd.

¹⁷⁵ Ndeshja e futbollit mes Serbisë dhe Shqipërisë (UEFA kualifikimet për Euro 2016) u luajt në Beograd më 16. 10. 2014. Pas një serie incidentesh në terren dhe jasht tij, ndeshja u ndërpre: tifozët serbë kanë hedhur flakadanë dhe objekte të tjera në terren, e më pas në një moment mbi stadium u lëshua droni që bartte një hartë të Shqipërisë së Madhe, gjë që shkaktoi reagime të dhunshme në mesin e lojtarëve dhe tifozëve të të dy ekipeve. Ndeshja shkaktoi përkeqësim serioz të marrëdhënieve shqitaro-serbe: pasoi një seri sulmesh ndaj civilëve shqiptarë në Serbi, sikurse edhe ndaj popullatës greke ortodokse në Shqipëri. Meqë lojtarët shqiptarë refuzuan të vazhdojnë ndeshjen, ajo u ndërpre, UEFA i dënoi të dy ekipet dhe i urdhëroi ata që dy ndeshjet vijuese t'i luajnë pa publik. Ueb faqja e ESPN-së: <http://www.espnfc.us/european-championship-qualifying/story/2088456/qualifier-in-serbia-abandoned-because-of-drone-carrying-albanian-flag>; Ueb faqja B92: http://www.b92.net/eng/news/crimes.php?yyyy=2014&mm=10&dd=16&nav_id=91921; Ueb faqja The Times of Change: <http://www.thetoc.gr/eng/news/article/albanian-extremists-terrorize-greek-minority-village> /vizituar më 22. qershor 2015/ Është interesante se Shqipëria ka luajtur kundër Portugalisë një muaj më herët, më 7.9. 2014, dhe atëherë, pasi kombëtarja e Shqipërisë fitoi, komentet në portalet sportive serbe ishin kryesisht pozitive; Po përmendim vetëm disa prej frazave që lexuesit i kanë përdorur në këto komente: “vëllezërit tanë”, “fqinjët”, dhe ngjashëm (krah. http://sport.b92.rs/sport/komentari.php?nav_id=897149 (vizituar më 22. maj 2015).

Hulumtimi rreth pikës se në ç’masë është reflektuar konflikti në statusin e folësve të shqipes në Beograd, ka treguar se shumicës (78%) konflikti i Kosovës ia ka vështirësuar pozitën dhe përdorimin e gjuhës shqipe në publik, gjë që tregon se statusi i folësve të shqipes në Beograd është i ndjeshëm dhe varet nga konflikti në Kosovë, siç shihet nga Grafiku 11 më poshtë. Folësit në komentet e tyre kanë theksuar dy aspekte qenësore të shprehjes së agresivitetit të shkaktuar nga konflikti në Kosovë: (i) format e diskriminimit etnik në rrethin e punës apo shoqërisë (p.sh. mes bashkëmoshatarëve); (ii) shprehja publike e mostolerancës në formë të grafiteve apo artikujve gazetareskë në internet.

Grafiku 11. Ndikimi i konfliktit në Kosovë në statusin e folësve dhe përdorimin e gjuhës shqipe në Beograd



Folësit theksuan veçanërisht se grafitet antishqiptare dhe nacionaliste në rrugët e Beogradit kanë ndikim kërcënues dhe i bëjnë të ndihen të rrezikuar. Është me rëndësi të theksohet se grafitet antishqiptare janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me krizën në Kosovë (p.sh. grafiti *Vdekje shqiptarëve* ka të bëjë me shqiptarët e Kosovës).¹⁷⁶

Edhe pse ndoshta nuk duket qartë ndikimi i konfliktit të Kosovës në statusin e folësve dhe përdorimin e gjuhës shqipe në Beograd, ai kursesi nuk duhet nënçmuar. Mjaft të kujtojmë dy episodet të paradokoshme. I pari ka të bëjë me dhunën në Kosovë që nisi më 17 mars të vitit 2004, dhe që u drejtua kundër serbëve dhe jo-shqiptarëve

¹⁷⁶ *Shqip(ë)tar* është termi në shqip për etnonimin (endonim) që përdoret nga shqiptarët kur ata i referohen vetes si bashkësi. Kur përdoret termi *Shiptar* në gjuhët e sllavëve të jugut, konsiderohet se është përbuzës dhe bën pjesë në fjalorin politikisht jokorrekt. Ndaj, termi zyrtar është Albanac (krahu Wilmer, 2004, fq.100; Zdravković, 2005, fq.230). Megjithatë, duhet dalluar përdorimi përbuzës i këtij etnonimi në diskursin zyrtar, medial dhe nationalist, prej përdorimit të tij në rajonet që popullohen bashkërisht nga serbët dhe shqiptarët, veçanërisht në Kosovë dhe Metohi, ku në të folurit fshatar serb ky është një etnonim i thjeshtë, që nuk është i shënuar në mënyrë ekspresive (krahu Ilić, 2007, fq.151). Sipas etnologes Sanja Zlatanović (Sanja Zlatanović) (2005, fq.88) termi ‘Shiptar’ në të folurit serbisht në Viti të Kosovës do të thotë ose përgjithësisht ‘shqiptar’, ose në mënyrë më specifike ‘shqiptar mysliman’, ndërsa etnonimi *Latin* (apo *Rimokatolik*) ka të bëjë me ‘shqiptarin katolik’. Megjithatë, në rastin e grafiteve serbe, përdorimi i etnonimit ‘Shiptar’ është dallueshëm përbuzës.

tjerë, si dhe kundër objekteve fetare ortodokse.¹⁷⁷ Trazirat në Kosovë shkaktuan reagime të dhunshme në Serbi, ku u dogjën xhamitë në Beograd dhe Nish, u thyen xhamat e Bashkësisë Islame në Novi Sad dhe u shkatërruan shumë shitore të vogla që supozohet se u takonin shqiptarëve. Episodi tjetër që tregon se si ndikon konflikti i Kosovës në marrëdhëniet ndëretnike në Serbi, ka të bëjë me ndeshjen e lartëpërmendur të futbollit mes Shqipërisë dhe Serbisë, e cila u luajt në tetor të vitit 2014 në Beograd.¹⁷⁸

Incidentet që ndodhën në terren dhe stadium, mes të cilave më provokativ ishte droni me hartën e Shqipërisë së Madhe me Kosovën, provokuan më pas një seri sulmesh kundër shqiptarëve që jetojnë në Serbi; dhe anasjelltas, ato përleshje në Beograd shkaktuan sulme kundër popullatës greke ortodokse që jeton në Shqipëri. Marrë përgjithësisht, statusi i popullatës shqiptare dhe myslimane në Beograd është përkeqësuar si rezultat i këtyre ngjarjeve.

Shqyrtimet përfundimtare

Punimi hulumton praktikën shumëgjuhësore, idologjitë gjuhësore dhe lidhjen e tyre me konfliktin etno-politik, ndaj përdor shembujt e gjuhës shqipe në Beograd. Nga njëra anë, Beogradi është një kryeqytet tipik evropian me ideologji mbi-zotëruese njëgjuhësore. Megjithatë, për shkak të krizës shoqërore-ekonomike dhe periudhës së luftës së viteve 90-të, Beogradi ka pasur një zhvillim ndryshe nga shumica e kryeqyteteve evropiane. Në lidhje me këtë, përdorimi i gjuhës shqipe është shumë më i ndërlikuar për analizë se sa përdorimi i ndonjë gjuhe tjetër minoritare, para së gjithash për shkak të konfliktit serbo-shqiptar që u përshkallëzua në vitet 1998-1999 në Kosovë, dhe që ka mbetur ende i pazgjidhur deri në ditët e sotme.

Studimet e konflikteve tregojnë se identitetet kolektive dhe konfliktet janë të lidhura ngushtë, ku gjuha shpesh ka rol shumë të rëndësishëm në parandalimin, zhvillimin dhe ndaljen e konfliktit; dhe anasjelltas, përdorimi i gjuhës mund të varet nga konflikti. Rasti i gjuhës shqipe në Beograd është edhe një rrëfim për varësi të ndërsjellë të konfliktit dhe gjuhës. Hulumtimi sociolinguistik tregon se përdorimi i gjuhës shqipe dhe statusi i shqipfolësve në Beograd është i ndërlikuar. Gati gjysma e folësve janë rritur në Beograd (40%), më tej në Serbinë jugore (22%), ndërsa vetëm një numër i vogël janë rritur në Kosovë (3%). Befasisht e lartë është përqindja e shqipfolësve ortodoksë (36%), që është gati e njëjtë me numrin e muslimanëve (39%), që tregon se në shumë raste folësit e gjuhës shqipe në Beograd rrjedhin nga familje të përzierë etnikisht.

Përdorimi i gjuhës shqipe është kompartmentalizuar dhe reduktuar në disa domene, siç është rrethi familjar dhe ai i miqve, Katedra e Gjuhës Shqipe në Universitetin e Beogradit dhe xhamia Bajrakli. Sipas kërkimit tonë, njëra gjysmë e folësve shpesh e përdor gjuhën shqipe në rrethin e familjes dhe të miqve, ndërsa gjysma tjetër përdor gjuhën serbe në të gjitha domenet. Pakica shqiptare në Beograd është, pra, e fshehur;

¹⁷⁷ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian: <http://www.osce.org/fom/30265?download=true> (pp. 15) /vizituar më 27. 01. 2015/

¹⁷⁸ Shih fusnotën 14.

folësit ose e përdorin gjuhën kryesisht në domenet private, ose kalojnë nëpër procesin e zëvendësimit të gjuhës me atë serbe në të gjitha domenet. Hulumtimi ynë tregon se pakica shqiptare në Beograd është goxha e asimiluar, sepse anjë nga folësit nuk ka përmendur një zakon apo ritual tipik shqiptar që kryhet në rrethin e familjes.

Një numër i madh folësish ka thënë se kurrë nuk e përdor gjuhën shqipe në vend publik, në rrugë, nëpër kafene, kafe, etj. Një e treta kanë thënë se i shmangen përdorimit të gjuhës shqipe në publik. Megjthatë, nëse u vjen rasti, shumica e shqipfolësve e përdorin gjuhën shqipe lirshëm në vende publike, pa marrë parasysh konfliktin e Kosovës. Shumë prej tyre e përdorin gjuhën shqipe si „gjuhë sekrete“, atëherë kur nuk duan që t'i kuptojnë njerëzit nga rrethi i tyre. Në shumë komente folësit kanë theksuar se serbët kryesisht nuk e njohin gjuhën shqipe, ndaj dhe nuk mund ta njohin kur e dëgjojnë në një vend publik.

Veçanërisht interesante ishte të shihet çfarë mendojnë folësit për dobinë e njohurisë së gjuhës shqipe; në fakt, shumica konsideron që njohuria e shqipes u ka ardhur në ndihmë pak apo aspak në jug të Serbisë, në Beograd, në Mal të Zi apo vende të huaja, që janë mjedise njëgjuhësore apo dygjuhësore serbe. Nga ana tjetër, sa i përket lidhjeve emotive, dy të tretat e folësve e përfjetojnë Beogradin si vendin me të cilin janë më të lidhur, pasojnë Serbia dhe Kosova, me të cilat janë jashtëzakonisht të lidhur më shumë se gjysma e të intervistuarve. Këto shënime tregojnë se atdheu (Serbia) është i rëndësishëm për folësit e shqipes njësoj si vendi që përjetohet si qendër etnike (Kosova). Kur u pyetën nëse prejardhja shqiptare dhe njohja e gjuhës u ka sjellë dobi apo dëm në Beograd, një numër thujse i barabartë janë përgjigjur se u ka sjellë vetëm dobi (15%) dhe se u ka sjellë vetëm dëm (18%), ndërsa të tjerët kanë zgjedhur përgjigjen „të tjera“, që tregon se kjo varet nga përvoja personale.

Konflikti në Kosovë, që ka arritur kulmin gjatë dy dekadave të fundit, ka ndikuar në masë të madhe në pozitën e folësve dhe ka vështirësuar përdorimin e gjuhës shqipe në vendet publike në Beograd. Folësit kanë theksuar posaçërisht se ndjehen të kërcënuar nga grafitet me përmbajtje nacionaliste apo armiqësore ndaj shqiptarëve rrugëve të Beogradit. Format e tjera të diskriminimit, si presioni dhe ndjenjat antishqiptare që vijnë nga bashkëmoshatarët dhe nga rrethi i punës e ai privat, janë më pak prezente. Në fund, edhe pse përdorimi i gjuhës shqipe në Beograd është vështirësuar në masë të madhe për shkak të konfliktit në Kosovë, ne pohojmë se krahas traumës dhe mostolerancës, ekziston edhe një potencial i rëndësishëm për përmirësimin e tolerancës ndëretnike dhe të shumëgjuhësisë në qytet.

Literatura:

ВУЧИНА СИМОВИЋ, И., ФИЛИПОВИЋ, Ј. (2009). *Етнички идентитет и замена језика у сефардској заједници у Београду*. Београд: Завод за уџбенике и наставна средства.

ЂУРИЋ, В., ТАНАСКОВИЋ, Д., ВУКМИРОВИЋ, Д. (2014). *Етноконфесионални и језички мозаик Србије*. Београд: Републички завод за статистику.

ЗЛАТАНОВИЋ, С. (2005). Свакодневица у енклави. *Гласник Етнографског института САНУ* 53, 83–92.

ПОПИС СТАНОВНИШТВА 2011. *2011 Попис становништва, домаћинства и станова 2011. у Републици Србији. Вероисповест, матерњи језик и национална припадност по општинама и градовима*. 2013. Београд: Републички завод за статистику.

УСТАВ 2006 – Устав Републике Србије <http://www.predsednik.rs/mec/pic/doc/Ustav%20Srbije.pdf>

BALLA, M., BULJANOVIĆ, S., ILIĆ, M. (2012) Domains of Hungarian Language Use in Belgrade. *Jezikoslovlje*. 13 (2), fq. 571–588.

BARIĆ, H. (1950) *Rečnik srpskoga ili hrvatskoga i arbanskoga jezika* I. Zagreb: Izdavački zavod Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti.

BARIĆ, H. (1959) *Istorija arbanskog jezika*. Sarajevo: Naučno društvo Bosne i Hercegovine.

BLUMI, I. (2007) Albanian Catholic and Muslim communities in Kosovo and Macedonia. In Polzer, M., Devetak, S., Toplak, L., Unger, F., Eder, M. (red.) *Religion and European Integration. Religion as a Factor of Stability and Development in South Eastern Europe*. Proceedings of contributions from the Maribor Symposium 2005. European Academy of Sciences and Arts, 211-227.

BUNESCU, I. (2014) *Roma in Europe: The Politics of Collective Identity Formation*. Ashgate.

CSERGO, ZS. (2007). *Talk of the Nation. Language and Conflict in Romania and Slovakia*. Cornell University Press.

FILIPOVIĆ, J. (2009). *Moć reči: Ogledi iz kritičke sociolingvistike*. Београд: Задужбина Andrejević.

FOUCAULT, M. (1994). *Znanje i moć*. Zagreb: Globus.

GAL, S. (1979). *Language Shift: Social Determinants of Linguistic Change in Bilingual Austria*.

Academic Press INC.

GAL, S. (1993). Diversity and contestation in linguistic ideologies. German-speakers in Hungary. *Language in Society*, 22, fq. 337–359.

GUPTA, A., F. (2000). Bilingualism in the cosmopolis. *International Journal of the Sociology of*

Language. 143: (1), 107–120.

IANS (2013) *Izveštaj albanskog nacionalnog saveta o nadziranju implementacije Ev-*

ropske povelje za regionalne i manjinske jezike: Report of the National Council of Albanian National Minority in Monitoring of the Implementation of European Charter for Regional or Minority Languages. [Online] Bujanovac: National Council of Albanian National Minority in the Republic of Serbia. E disponueshme në:

<http://www.knsh.org/Portals/0/Plani/Report%20of%20the%20National%20Council%20of%20Albanian%20National%20Minority%20in%20Monitoring%20of%20the%20Implementation%20of%20European%20Charter%20for%20Regional%20or%20Minority%20Languages.pdf> [vizituar më: 23. 06. 2015]

ILIĆ, M. (2007). A Shift in Ethics. The Serb/Albanian conflict in the vernacular discourse of a

conjurer from Kosovo. *Zeitschrift für Balkanologie* 43 (2), 145–167.

KASTRATI, J. (2000). *Historia e albanologjisë (Vëllimi i parë 1497 – 1853)*. Tiranë: Argeta/LMG.

KORDIĆ, S. (2010). *Jezik i nacionalizam*. Zagreb: Durieux.

KYMLICKA, W. (2001). *Politics in the Vernacular: Nationalism, Multiculturalism, Citizenship*. Oxford: Oxford University Press.

MAKSIMOVIĆ, I. (2010). Economic Effects of Development of Higher Education in Bujanovac and Preševo. *Higher Education in Bujanovac and Preševo. Feasibility Study on the Opportunities for Higher Education Development in South Serbia*. Belgrade: Centre for Non-Violent Resistance and Centre for Education Policies, fq. 37–52.

LAW 2010. Law on Official Use of Languages and Alphabets. *The Official Gazette of the Republic of Serbia* 101/2005, 30/2010. (Në serbisht: Zakon o službenoj upotrebi jezika i pisma; *Službeni glasnik republike Srbije* бр. 45/91, 53/93, 67/93, 48/94, 101/05, 30/10; shiko edhe www.puma.vojvodina.gov.rs/dokumenti/zakoni/Zakon_sluzbenoj_upjezika_pisma.pdf) [vizituar më 23. 06. 2015]

MARUSHIAKOVA, E. et al. (2001). *Identity formation among the minorities in the Balkans: The case of Roma, Egyptians and Ashkali in Kosovo*. Sofia: Minority Studies Society Studii Romani.

MILROY, J., MILROY, L. (1985) *Authority in language: Investigating language prescription and standardisation*. London: Routledge & Kegan Paul.

NENADIĆ, D. (2010). Description and Brief History of Preševo, Bujanovac and Medveđa.

Higher Education Development in Preševo and Bujanovac. Feasibility Study on the Opportunities for Higher Education Development in South Serbia. Belgrade: Centre for Non-Violent Resistance and Centre for Education Policies, fq. 31–36.

POPULATION CENSUS IN ALBANIA 2011. Summary available at:

http://www.instat.gov.al/media/177358/njoftim_per_media_-_fjala_e_drejtorit_te_instat_ines_nurja_per_rezultatet_finale_te_census_2011.pdf. [vizituar më 10. 07. 2015]

PERUNIČIĆ, A. J. (2015). Minority languages in formal education in Serbia. Presentation given at the XV International Conference on Minority Languages, May 28-30, 2015 at the Faculty of Philology University of Belgrade.

SMITH, D. (1998). *Language and Discourse in Conflict and Conflict Resolution*. Në: Wright, S. (red.)

1998. *Language and Conflict. A Neglected Relationship. Multilingual Matters*, fq. 18-42.

STODIEK, TH. (2006). *The OSCE and the Creation of Multi-Ethnic Police Forces in the Balkans*. CORE Working paper 14. Hamburg: Institute for Peace Research and Security Policy at the University of Hamburg, 43-60. I disponueshëm në: http://ifsh.de/file-CORE/documents/CORE_Working_Paper_14.pdf [vizituar më 23. 06. 2015]

ËRIGHT, S. (red.) (1998). *Language and Conflict. A Neglected Relationship. Multilingual Matters*.

ZDRAVKOVIĆ, H. (2005): *Politika žrtve na Kosovu: Identitet žrtve kao primarni diskurzivni cilj Srba i Albanaca u upornom sukobu na Kosovu*. Belgrade.

ZEMON, R. Istorija identiteta Aškalijs. *Interkulturalizam i Bolonja proces*. I disponueshëm në:

http://www.coe.int/t/dg4/education/ibp/source/2.0_ashkali_serbian_corr.pdf [vizituar më 23. 06. 2015]

Marija Mandić

Ana Sivački

Faculty of Philology

University of Belgrade

Language Use and Ethno-political Conflict: The Case of Albanian in Contemporary Belgrade

Abstract:

The use of Albanian in Belgrade and particularly its dependency on the Serbian-Albanian conflict in Kosovo is *discussed herein*. *The paper initially gives* an overview of the Albanian minority in Serbia, its demographics, institutions and language use. Drawing on the results of the sociolinguistic survey carried out among the Albanian speakers in Belgrade, the paper then analyses use of Albanian and its dependence on the ethno-political conflict.

Key words:

sociolinguistics, conflict studies, Albanian language, Belgrade, language use, language ideology, conflict in Kosovo, multilingualism